

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** me Kryetaren e kolegjit Afijete Sada-Gllogjani, Xhavit Elezi dhe Ismet Këndusi, anëtar dhe sekretaren juridike Vjollca Gaxha, në çështjen juridike të propozuesve J. U. Sh., e vajzërisë H. nga Gjermania, përfaqësuar nga A. I. avokat në Prishtinë dhe propozuesit S. Sh. nga R.- Gjakovë, përfaqësuar nga B. H. avokat në Gjakovë, për zgjidhje të martesës shkurorëzim me marrëveshje, në shqyrtimin kryesor jo publik, në prezencën e të autorizuarve të propozuesve të mbajtur me datë 11 tetor 2016, murr këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. ZGJIDHET** me shkurorëzim martesë me marrëveshje në mes të propozuesve J. U. Sh. e vajzërisë H. e lindur me 28 qershor 1990 në B. Odenwald, Gjermani dhe S. Sh. i lindur me 19 janar 1994 në Gjakovë e lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, Rogovë numër rendor 36 numri i referencës 2/2014RM/2010 me datë 14 shtator 2016.

**II.** Konsiderohet e tërhequr kërkesa e propozueses J. U. Sh. e vajzërisë H. në mbiemrin para lidhjes së martesës në J. U. H. dhe që të njoftohet Zyra e Gjendjes Civile në Rogovë, Komuna e Gjakovës lidhur me kthimin e mbiemrit të mëparshëm propozueses.

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## **A r s y e t i m**

Fillimisht paditësja me padi dhe nëpërmjet të autorizuarit te saj ka kërkuar anulimin e martesës të lidhur me datën 18 shtator 2014, pranë Zyrës së Gjendjes civile në Gjakovë. Një herit ka kërkuar që të i kthehet mbiemri i saj para lidhjes së martesës dhe të njoftohet Zyra e Gjendjes civile në Rogovë, Komuna e Gjakovës që paditëses të i kthehet mbiemri i vajzërisë.

Me parashtrësën e datës 22 shtator 2016 i autorizuari i paditëses ka ndryshuar padinë dhe kërkesë padinë duke propozuar që martesë të zgjidhet shkurorëzohet me marrëveshje të palëve, gjegjësisht të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozim për shkurorëzim të martesës me marrëveshje.

Gjatë shqyrtimit i autorizuari i paditëses ka deklaruar se gjatë jetës së përbashkët bashkëshortët nuk kanë pasur fëmijë dhe nuk presin që të kenë. Sa i përket kërkesës për ndërrimin e mbiemrit të paditëses në atë para lidhjes së martesës dhe që të njoftohet Zyra e Gjendjes civile në Rogovë, Gjakovë që paditëses të i kthehet mbiemri i vajzërisë ka bërë tërheqjen e kërkesës. Ka propozuar që martesë të zgjidhet më propozim të përbashkët të bashkëshortëve në bazë të marrëveshjes së ndërsjellët dhe sipas dispozitave përkatëse të Ligjit për Familjen.

Shpenzime procedurale nuk kërkoi dhe hoqi dorë nga e drejta në ankesë kundër Aktgjykimit.

I autorizuari i të paditurit është pajtuar në tërësi që martesë në mes të palëve ndërgjyqësve të zgjidhet me marrëveshje. Bashkëshortët gjatë jetës së përbashkët nuk kanë pas fëmijë të përbashkët dhe as që presin të kenë. Nuk ka kundërshtuar propozimin e të autorizuarit te paditëses për tërheqjen e kërkesës nën pikës II. dhe e III sipas parashtrësës së palës paditëses të datës 22 shtator 2016.

Bazuar në theksimet e mëparshme martesë faktike ka pushuar se ekzistuari dhe nuk ka mundësi të rivendosjes së saj, për atë janë plotësuar dhe kushtet ligjore që martesë të zgjidhet me propozim të përbashkët të ndërgjyqësve.

Shpenzime procedurale nuk kërkoi dhe hoqi dorë nga e drejta në ankesë kundër Aktgjykimit.

Të autorizuarit e ndërgjyqësve gjatë shqyrtimit kanë qenë të pajtimit që martesë të shkurojëzohet me marrëveshje, Gjykata padinë e trajtoj propozim të përbashkët për zgjidhje të martesës me shkurojëzim, sipas nenit 68.4 të Ligjit për familjen të Kosovës.

Kërkesat e propozueses për ndryshim të mbiemrit para lidhjes së martesës në J. U. H. dhe që të njoftohet Zyra e Gjendjes Civile në Rogovë, Komuna e Gjakovës lidhur me kthimin e mbiemrit të propozueses u konsideruan të tërhequra.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave; ku pas vlerësimit veç e veç të tyre dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe nenin 68 pika 2 të Ligjit për Familjen të Kosovës aprovoj propozimin për zgjidhje të martesës.

Gjatë shqyrtimit kryesor Gjykata bëri nxjerrjen e provave; Certifikatës së martesës të lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, Rogovë, numër rendor 36, numri i referencës 2/2014RM/2010 të datës 14 shtator 2016 dhe Mendimit të Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë numër 963/16 të datës 04 korrik 2016.

Nga Certifikata e martesës u vërtetuar se propozuesit kanë lidh martesë pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, Rogovë me datë 18 shtator 2014.

Sipas konstatimit të Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë procedura e pajtimit të bashkëshortëve nuk është zhvilluar sepse propozuesja jetojnë jashtë Kosovës në Gjermani ndërsa propozuesi ka qenë kategorik për zgjidhje të martesës me shkurojëzim nga se ata kohë më parë kanë shkëputur atë bashkësi.

Duke u gjendur pranë kësaj gjendje faktike Gjykata konsideron se martesë ka humbur qëllimin dhe efektin e vetë për të cilën është lidh, përkatësisht martesë lidhet në bazë të dashurisë, besnikërisë si dhe vullnetit reciprok të bashkëshortëve. Me qenë se në rastin konkret mungojnë këto elemente qenësore, për ekzistimin e martesës, Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të caktuara në dispozitën e nenit 69 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Familjen të Kosovës, ku janë paraparë shkaqet e shkurojëzimit si shkaqe të përgjithshme dhe shkaqe të veçanta. Shkaqet e përgjithshme të shkurojëzimit të parapara në nenin 69 paragrafi 1 të Ligjit për Familjen të Kosovës, bashkëshortët mund të kërkojnë shkurojëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, mos përputhja e karaktereve dhe grindja e vazhdueshme e bashkëshortëve, gjersa shkaqet e veçanta janë paraparë në nenin 69 paragrafi 2 të njëjtë Ligj, jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, vepra penale kundër jetës së bashkëshortëve, keqtrajtimi serioz, lënia qëllim keqe dhe e pa arsyeshme, sëmundjet psikike të pa shërueshme dhe pa aftësia për të vepruar, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike bashkëshortore për më shumë se një vit dhe zgjidhja e martesës me propozim të përbashkët.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale që secila palë të i bart shpenzimet e veta procedurale u murr sipas nenit 450 të Ligjit për Familjen të Kosovës bazuar në mos kërkesën e shpenzimeve nga ana e të autorizuarve të propozuesve.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi me qenë se janë plotësuar kushtet për zgjidhjen e kësaj martesë në mes bashkëshortëve.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**C. nr. 111/16 , Datë 11 tetor 2016**

**Kryetarja e kolegjit,**  
**Afijete Sada-Gllogjani**

**UDHËZIM JURIDIK:** Ky Aktgjykim është i formës së prerë sepse të autorizuarit e propozuesve kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë.